REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar me: / Primljeno: | 12.09.2024 | |
|---|---|---|
| Njesia / Jednica | Numri / Broj | Shtojca / Dodatak |
| 15-020/08-45700 | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

| | |
|---|---|
| NR | |
| DATË | 12.09.2024 |
| PËR | Daut Azemi , Kryesues i Kuvendit Komunal Lipjan |
| NGA | Z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit |
| LËNDA | Kërkesë për procedim për pikë të rendit të ditës në Kuvendin e Komunës |

Kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës ta parasheh në rend të ditës si pikë të veçantë shqyrtimin - diskutimin e Raportit të performancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2023.

Shtojcë:
1. Raporti i performancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2023.

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVO
:

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

| | |
|---|---|
| Datë : | 11.09.2024 |
| Referencë : | |
| Për: | Imri Ahmeti- Kryetar i Komunës se Lipjanit |
| Kopje : | Elmaze Behluli – Drejtoreshe e Administratës |
| Nga: | Shemsi Azemi, Kordinator komunal për performancë në Komunën e Lipjanit |
| Lënda: | Raporti i performancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2023 |

SMPK (Sistemi për Menaxhimin e Performancës së Komunave ) , bën matjen e performancës së komunave për 16 fusha të ndryshme themelore

Komuna e Lipjanit ka shënuar një progres në raportin e SMPK, në nivel vendi me 81.57 %, po ashtu edhe në radhitjen e Grandi i performancës jemi të kualifikuar për grandë.

Fushat themelore për të cilat bëhet matja e performancës së komunave në këtë rast edhe të Komunës sonë janë :

a) Fusha 1. Shërbimet Administrative
b) Fusha 2. Transparenca komunale
c) Fusha 3. Përgjegjshmëria komunale
d) Fusha 4: Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare
e) Fusha 5. Kulturë, Rini dhe Sport
f) Fusha 6. Menaxhimi i Fatkeqësive Natyrore
g) Fusha 7. Planifikimi Hapësinor
h) Fusha 8: Hapësirat publike
i) Fusha 9. Infrastruktura Rrugore
j) Fusha 10. Transporti Publik
k) Fusha 11. Shërbimet Publike
l) Fusha 12. Mbrojtja e Mjedisit
m) Fusha 13. Përfaqësimi Gjinor
n) Fusha 14. Arsimi Parauniversitar
o) Fusha 15. Kujdesi Primar Shëndetësor
p) Fusha 16. Zhvillimi Ekonomik Lokal

Në vazhdim e paraqesim në përmbledhje të përgjithshme performancen e komunës sipas fushave te caktuara , në fushat ku përformanca është e lartë, e mesme dhe ku performanca është e ulët.

KOMUNA E LIPJANIT

Përmbledhje e përgjithshme

Performanca e përgjithshme e komunës në 16 fusha të matjes është 81.57%. Fusha me performancën më të lartë është, Transparenca Komunale me 100 % fusha Kulture Rini dhe sport me 100 %, Menagjimi i fatkeqësive me 100 , janë treguesve të përmbushur, derisa fusha me performancën më të ulët është Infrastruktura rrugore me 59.85%. Performancë shumë e lartë është treguar edhe në fushën përgjegjshmërisë komunale me 92.72%, mbrojtja e mjedisit 58.33%, menaxhimi i fatkeqësive me 100%, shërbimet administrative me 98.61%, transporti publik 60.54%, Shërbimet Publike 99.45.% dhe fusha e kujdesit primar shëndetësorë me 98.45%. Fushat për të cilat duhet t'iu jepen prioritet janë: infrastruktura rrugore me 59.85%, e pasuar nga përfaqësimi gjinorë me 58.85%, barazia në punësim me 57.42% .

Nga 85 tregues gjithsej në vlerën 100% janë 43 tregues që shprehur në përqindje janë 50.58% e treguesve. Ndërsa nga 85 tregues nivel të ulët të arritjes kanë 25 tregues që shprehur në janë 29.41% e treguesve, kurse 17 treguesve janë në nivel të mesëm të arritjes që shprehur në përqindje paraqet 20 %.

Komuna ka respektuar kriteret për dokumentimin e të dhënave komunale të cilat janë në nivel të kënaqshëm të prezantimit të referencave të caktuara në formularët e raportimit brenda organeve komunale apo jashtë komunës nga ndërmarrjet publike komunale dhe institucionet tjera lokale. Po ashtu komuna e ka pambushur kriterin e raportimit për të gjithë treguesit e përformancës komunale.

PERFORMANCA SIPAS FUSHAVE

Fusha 1. Shërbimet Administrative

Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 95.84%, apo 2.02% më e larte se në periudhën e njëjtë të vitit 2022, Komuna ka pranuar gjithsej 70973 kërkesa në procedurë administrative të parashtruara nga qytetarët, prej të cilave 68,024 janë shqyrtuar apo 95.04%, kurse 4.15% e kërkesave nuk janë shqyrtuar, apo kanë mbetur në proces të shqyrtimit. Kërkesat e parashtruara për të cilat ka pasur proces të shqyrtimit administrativ, kanë përfunduar brenda afatit ligjor.

Fusha 2. Transparenca komunale

Performanca e përgjithshme në fushën e transparencës është 100%. Që edhe në vitin 2022 ka qenë 100 %.

Komuna ka shënuar performancë të lartë prej 100% në treguesin, Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online komuna ka performancë prej 100%, Niveli i qasjes në dokumente publike Performancë prej 100% Përmbushja e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës 100%, Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqen zyrtare të komunës 100%, Publikimit i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës 100%, Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit 100%, Publikimi i dokumenteve të

prokurimit publik dhe i kontratave 100%. Komuna e Lipjanit ka dokumentuar të dhënat sipas udhëzimeve dhe kritereve të përcaktuara nga MPL.

### Fusha 3. Përgjegjshmëria komunale

Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 92.72% edhe në këtë fushë komuna ka raportuar performancë të lartë se performanca dhe reale. Gjatë fazës së verifikimit të dhënave të dhënat kanë qen të referuara mirë në dokumente burimore të paraqitura në dokumentin e raportimit nga ana e komunës dhe në referenca të caktuara nga ueb-faqja e komunës apo dokumente tjera.

Treguesi, Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike ka performancë prej 100%, Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike 55.32%, Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun 100%, dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal 100%, Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike 100%, Këshillat lokal që kanë mbajtur së paku 6 takime në vit 100%, Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak 100%, Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Asamblenë Komunale 100%, Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Asamblenë Komunale 100%, Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës 100%, Niveli i zbatimit të planit të prokurimit 90.91%, Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve 99.73%, Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit 58.33%, Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal 100%, Suspendimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre 100%, ,

Vlen të theksohet se komuna e Lipjanit në fushën 3 ka performancë të lartë gati në të gjithë treguesit dhe ka dokumentim të dhënave në nivel të kënaqshëm.

### Fusha 4: Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare

Ndonëse fusha ka kaluar përmes procesit të riorganizimit të treguesve dhe rezultateve, krahasimi i performancës së treguesve në nivel të fushës rezulton me 57.42% . Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social 90.00%, Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar 100%,

### Fusha 5. Kulturë, Rini dhe Sport

Ndonëse fusha ka pasur riorganizmin në nivel të treguesve, krahasimi i performancës në nivel të fushës për Kulturë, Rini dhe Sport pasqyron lëvizje pozitive, ku për vitin e raportuar rezultati i arritur është 100%. Krahasimi me rezultatin e vitit 2022 ku përqindja ishte 100%,

### Fusha 6. Menaxhimi i Fatkeqësive Natyrore

Përqindja totale e arritur në këtë fushë është 100% dhe është e më e larte . Niveli i përgjithshëm i realizimit të planit Komunal për menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe të tjera është konstatuar të jetë 100%, ashtu që nga 10 veprime të parapara në këtë plan u realizuan 10 sosh.

### Fusha 7. Planifikimi Hapësinor

Komuna e Lipjanit ka një territor prej 33864,0911 km2, apo 1022,8 ha, janë të mbuluara me plane rregulluese të hollësishme. Përqindja e arritur në këtë fushë është 98.56% .

### Fusha 8: Hapësirat publike

Përqindja totale e arritur në këtë fushë është 65.07% dhe është shumë në nivel të njet sikurse vitin paraprak 2022

Fusha 9. Infrastruktura Rrugore

Fusha e Infrastrukturës Rrugore ka pësuar ndryshime në aspektin e përmbajtjes së treguesve, mirëpo krahasimi i përformancës së arritur për vitin e raportuar 59.85 % me performancën e vitit 2023% tregon për një rritje të ndjeshme të përqindjes.

.

Fusha 10. Transporti Publik

Në fushën e Transportit Publik komuna e Lipjanit ka arritur performancë me 60.54%. Plani i veprimeve për transportin publik komunal ka paraparë 3 veprimtari, ku të gjitha 3 janë përmbushur, vlera e treguesit është 100%, kurse tek treguesi për përfshirjen e vendbanimeve në ofrimin e transportit publik është deklaruar nga 62 vendbanimet në nivel të komunës, 57 ose 91.9% janë të përfshira në transportin publik. Kurse sa i përket sigurimit të vendnalimeve të shenjëzuara, është raportuar për 37 prej 194 vendnalimeve që i ka komuna e Lipjanit.

Fusha 11. Shërbimet Publike

Fusha e shërbimeve publike shënon një rritje 99.45% nëse krahasohet me performancën e vitit 2022.

Fusha 12. Mbrojtja e Mjedisit

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit komuna e Lipjanit ka shënuar një ramje të performancës, ku në vitin e raportimit ka arritur performancë prej 58.33% në raport me performancën e vitit paraprak

.

Fusha 13. Përfaqësimi Gjinor

Është kjo fushë e re, për herë të parë e zbatuar në raportimin e vitit 2023, e përbërë prej 3 rezultateve dhe 11 treguesve. Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 58.85%, ka nje rritje te performances në krahasim me vitin 2022 .

Fusha 14. Arsimi Para universitar

Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 70.45%,.

Fusha 15. Kujdesi Primar Shëndetësor

Është kjo fushë e re, për herë të parë e zbatuar në raportimin e vitit 2023, e përbërë prej 3 rezultateve dhe 7 treguesve. Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 98.75%, paraqet një rritje në krahasim me vitin paraprak.

Fusha 16. Zhvillimi Ekonomik Lokal

Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 86.74%. Plani për zhvillim ekonomik lokal është raportuar si i realizuar, me performancë prej 100%, komuna e ka azhurnuar dhe publikuar listën e pronave publike për dhënie në shfrytëzim me qëllim të mbështetjes së zhvillimit ekonomik, është përmbushur performanca prej 100%,

# Raporti përfundimtar I performances për viti 2023 Komuna Lipjan

Raporti i performancës së komunës së Lipjanit përmbledh rezultatet e një procesi i cili ka përfshirë:
Raportimin nga zyrtarët komunal: Zyrtarët komunal raportuan për peformancën e vitit 2023 në Sistemin elektronik të menaxhimit të performancës komunale nga data 15.02.2024 deri në datën 11.04.2024.

Konsultim Paraprak: Kjo fazë është zhvilluar gjatë periudhës së raportimit nga komunat. Në këtë fazë zyrtarët e divizioni të performancës komunale të MAPL kanë udhëzuar zyrtarët raportues për plotësim/korrigjim të të dhënave të raportuar. Përgjigjet në komentet e ministrisë janë vendosur në platformën e konsultimit dhe/ose në platformën e raportimit.

Verifikim me mostër: Pas përfundimit të procesit të raportimit nga komunat, u zhvillua një verifikim i detajuar i të dhënave për 27 treguesit e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale. Ky proces përfshinte analizën e dokumentacionit, të dhënave të raportuara dhe dëshmive të bashkëngjitura.

Verifikim në Terren: Për të siguruar vërtetësinë e të dhënave të raportuara dhe për të verifikuar zbatimin e tyre në terren, një ekip u angazhua për të kryer inspektimin fizik dhe monitorimin e aktiviteteve në vendet konkrete.

Rezultatet e performancës janë përfshirë në këtë raport, i cili ofron një pasqyrë të detajuar e performancës së komunave, përfshirë shënimet e konsultimit paraprak, verifikimit me mostër, verifikimit në terren dhe shqyrtimit te ankesave. Rezultatet e paraqitura ne këtë raport janë finale.

% E TREGUESVE SIPAS FUSHAVE

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE | 1.1.1 | Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit | 95.84 | 98.61 |
| | 1.1.2 | Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore GRANT | 100 | |
| | 1.1.3 | Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna | 100 | |
| TRANSPARENCA KOMUNALE | 2.1.1 | Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online GRANT | 100 | 100.00 |
| | 2.1.2 | Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët | 100 | |
| | 2.1.3 | Përmbushja e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës GRANT | 100 | |
| | 2.1.4 | Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës | 100 | |
| | 2.1.5 | Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës | 100 | |
| | 2.2.1 | Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit | 100 | |
| | 2.2.2 | Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës GRANT | 100 | |
| PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE | 3.1.1 | Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike | 100 | 92.72 |
| | 3.1.2 | Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike GRANT | 55.32 | |
| | 3.1.4 | Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun GRANT | 100 | |
| | 3.1.5 | Dëgjime publike për KAB, buxhet komunal dhe buxhetimi me pjesëmarrje GRANT | 100 | |
| | 3.1.6 | Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike | 100 | |
| | 3.1.7 | Funksionimi i këshillave lokal | 72.02 | |
| | 3.2.1 | Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal GRANT | 100 | |
| | 3.2.2 | Diskutime për raportet tre-mujore buxhetore nga Kuvendi Komunal GRANT | 100 | |
| | 3.2.4 | Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunale-GRANT | 100 | |
| | 3.2.6 | Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës GRANT | 100 | |
| | 3.3.1 | Niveli i zbatimit të planit të prokurimit GRANT | 90.91 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 3.3.2 | Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve | 99.73 | |
| | 3.3.3 | Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit- GRANT | 58.33 | |
| | 3.4.1 | Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal- GRANT | 100 | |
| | 3.4.2 | Pezullimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre | 100 | |
| BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE | 4.1.1 | Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale | 60.04 | 57.42 |
| | 4.1.2 | Zyrtarë Publik të punësuar nga komunitetet jo shumicë në institucionet komunale | 28.17 | |
| | 4.2.1 | Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi social | 41.46 | |
| | 4.2.2 | Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar | 100 | |
| KULTURË, RINI DHE SPORT | 5.1.1 | Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve | 100 | 100.00 |
| | 5.2.1 | Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal | 100 | |
| MENAXHIMI I FATKEQËSIVE | 6.1.1 | Niveli i realizimit të planit komunal për Reagim Emergjent | 100 | 100.00 |
| | 6.1.2 | Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera | 100 | |
| PLANIFIKIMI HAPSINOR KOMUNAL | 7.1.1 | Sipërfaqja e territorit të komunave të mbuluar sipas planeve zhvillimore të komunës.- GRANT | 100 | 98.56 |
| | 7.2.1 | Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit- GRANT | 94.24 | |
| | 7.2.2 | Objekte të inspektuara me leje të ndërtimit | 100 | |
| HAPËSIRAT PUBLIKE | 8.1.1 | Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra në m2 publike për kokë banori | 10.45 | 65.07 |
| | 8.1.2 | Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht | 100 | |
| | 8.1.3 | Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik | 84.75 | |
| INFRASTRUKTURA RRUGORE | 9.1.1 | Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës | 64.92 | 59.85 |
| | 9.1.2 | Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit | 70.77 | |
| | 9.2.1 | Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare | 30.6 | |
| | 9.2.2 | Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik | 44.05 | |
| | 9.2.3 | Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal | 52.68 | |
| | 9.3.1 | Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave | 31.94 | |
| | 9.3.2 | Rrugë lokale të riasfaltuara | 100 | |
| TRANSPORTI PUBLIK | 10.1.1 | Realizimi i planit komunal për transport lokal publik (planit të mobilitetit) | 0 | 60.54 |
| | 10.1.2 | Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik- GRANT | 91.94 | |
| | 10.1.3 | Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik | 89.69 | |
| SHËRBIMET PUBLIKE | 11.1.1 | Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit | 100 | 99.45 |
| | 11.1.2 | Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit | 100 | |
| | 11.1.3 | Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave | 100 | |
| | 11.1.4 | Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave | 100 | |
| | 11.1.5 | Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave | 97.27 | |
| MBROJTJA E MJEDISIT | 12.1.1 | Realizimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis- GRANT | 75 | 58.33 |
| | 12.1.2 | Lejet mjedisore komunale të lëshuara | 0 | |
| | 12.1.3 | Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale | 100 | |
| PËRFAQËSIMI | 13.1.1 | Gratë e punësuara në institucione administratën komunale | 100 | 58.85 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| GJINOR | 13.1.2 | Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive- GRANT | 75.53 | |
| | 13.1.3 | Gratë e emëruara në pozita politike në komunë- GRANT | 63.16 | |
| | 13.1.4 | Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale | 100 | |
| | 13.1.5 | Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale | 5.61 | |
| | 13.2.1 | Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor | 100 | |
| | 13.2.2 | Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave | 53.84 | |
| | 13.2.3 | Pjesëmarrja e grave në konsultime publike- GRANT | 79.71 | |
| | 13.2.4 | Plani komunal për barazi gjinore | 100 | |
| | 13.3.1 | Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve | 4.24 | |
| | 13.3.2 | Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive | 44.35 | |
| ARSIMI PARAUNIVERSITAR | 14.1.1 | Shkolla me masa të efiçencë së energjisë | 38.18 | 70.45 |
| | 14.1.2 | Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar | 92 | |
| | 14.1.3 | Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar | 100 | |
| | 14.2.1 | Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës | 70.04 | |
| | 14.3.1 | Fëmijë që vijojnë kopshtin - përgjithësi dhe rural- GRANT | 23.12 | |
| | 14.3.2 | Mesatarja në rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta | 46.46 | |
| | 14.3.3 | Kalueshmëria në maturën kombëtare për klasat 12 -të (ndarja sipas gjinisë)- GRANT | 61.45 | |
| | 14.3.4 | Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse) | 96.78 | |
| | 14.3.5 | Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit | 95.14 | |
| KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR | 15.1.1 | Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ | 100 | 98.55 |
| | 15.2.1 | Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral- GRANT | 100 | |
| | 15.2.2 | Fëmijë të përfshirë në program të imunizimit | 91.32 | |
| | 15.3.1 | Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë- GRANT | 100 | |
| ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL | 16.1.1 | Strategjia për zhvillim ekonomik lokal | 95.71 | 86.74 |
| | 16.1.2 | Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuar për dhënie në shfrytëzim- GRANT | 100 | |
| | 16.1.3 | Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë-GRANT | 100 | |
| | 16.1.4 | Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime) GRANT | 51.23 | |
| | | | | 81.57 |

# Rezultatet per Grant - Lipjan

## Roli i Kuvendit komunal si organ mbikqyres

| | | | | Piket Max | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|
| Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikëqyrës | 3.2.1 | Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal GRANT | 100 | 2 | 2 |
| | 3.2.2 | Diskutime për raportet tre-mujore buxhetore nga Kuvendi Komunal GRANT | 100 | 4 | 4 |
| | | Diskutimi i raportit e performances komunale nga Kuvendi Komunal per vitin e Kaluar | I ngrire | 2 | |
| | 3.2.4 | Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunale- GRANT | 100 | 2 | 2 |
| | 3.2.6 | Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës GRANT | 100 | 2 | 2 |
| | | | | 12 | 10 |

## Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve

| | | | | Piket Max | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|
| Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve | 3.1.2 | Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike GRANT | 55.32 | 4 | 1 |
| | 3.1.4 | Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun GRANT | 100 | 4 | 4 |
| | 3.1.5 | Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal (proporcionalisht ndaj # banorëve) | 100 | 4 | 4 |
| | | | | 12 | 9 |

## Transparenca, qasja në informata dhe integriteti

| | | | | Piket Max | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|
| Transparenca, qasja në | 2.1.1 | Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online GRANT | 100 | 4 | 4 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| informata dhe integriteti | 2.1.3 | Përmbushja e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës GRANT | 100 | 3 | 3 |
| | 2.2.2 | Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës GRANT | 100 | 3 | 3 |
| | 3.1.6 | Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike | 100 | 4 | 4 |
| | 3.4.1 | Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal- GRANT | 100 | 2 | 2 |
| | | | | 16 | 16 |

# Menaxhimi financiar

| | | | | Piket Max | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|
| Menaxhimi komunal | 16.1.3 | Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë-GRANT | 100 | 3 | 3 |
| | 16.1.4 | Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime) GRANT | 51.23 | 5 | 1 |
| | | Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga auditori i brendshëm | I ngrire | 2 | |
| | 3.3.3 | Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit- GRANT | 58.33 | 3 | 2 |
| | | | | 13 | 6 |

# Menaxhimi I kontratave

| | | | | Piket Max | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|
| Menaxhimi i kontratave | 3.3.1 | Niveli i zbatimit të planit të prokurimit GRANT | 90.91 | 3 | 3 |
| | 16.1.2 | Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuar për dhënie në shfrytëzim- GRANT | 100 | 4 | 4 |
| | | | | 7 | 7 |

# Menaxhimi i burimeve njerëzore

| | | | | Piket Max | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|
| Menaxhimi i burimeve njerëzore | 3.5.1 | Përgatitja e planit për zhvillimin e personelit | I ngrire | 2 | 0 |
| | 13.1.2 | Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive- GRANT | 75.53 | 5 | 1 |
| | 13.1.3 | Gratë e emëruara në pozita politike në komunë- GRANT | 63.16 | 3 | 1 |
| | | | | 10 | 2 |

| Piket | Rezultati |
|---|---|

## Sherbimet Administrative

| | | | | Max | |
|---|---|---|---|---|---|
| Sherbimet Administrative | | Shërbimet administrative të thjeshtuara për zvogëlimin e barrës administrative në nivel komuna | I ngrire | 4 | |
| | 7.2.1 | Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit | 94.24 | 2 | 2 |
| | | | | 6 | 2 |

## Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mbrojtja e mjedisit

| | | | | Piket Max | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|
| Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mbrojtja e mjedisit | 7.1.1 | Sipërfaqja e territorit të komunave të mbuluar sipas planeve zhvillimore të komunës.- GRANT | 100 | 3 | 3 |
| | 10.1.2 | Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik- GRANT | 91.94 | 3 | 3 |
| | 12.1.1 | Realizimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis- GRANT | 75 | 2 | 1 |
| | | | | 8 | 7 |

## Arsimi para -universitar

| | | | | Piket Max | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|
| Arsimi para-universitar | 14.1.3 | Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar | 100 | 4 | 4 |
| | 15.2.1 | Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral- GRANT | 100 | 4 | 4 |
| | | | | 8 | 8 |

## Kujdesi shëndetësor primar

| | | | | Piket Max | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|
| Kujdesi shëndetësor primar | 15.1.1 | Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ | 100 | 4 | |
| Kujdesi shëndetësor primar | 15.2.1 | Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral- GRANT | 100 | 4 | 5 |
| | | | | 8 | 5 |

| | Piket Max | Rezultati |
|---|---|---|
| Totali : | 90 | 72 |